




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUČITRN	
Nr. / Br.	51543/21
Nr. i fq. / Br. st.	- 1 -
Data: / Datum:	21/10/21
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga takimi me OJQ-të, të rinjtë, KVRL, mbajtur në Shtëpi të Kulturës-Vushtrri, lidhur me dëgjimet buxhetore për vitin 2022-2024

Mbledhja u mbajt me datën 26.08.2021 me fillim në ora 15:00, në Shtëpi të Kulturës -Vushtrri
Prezent nga zyrtarët e komunës:

1. z. Xhafer Tahiri- kryetar i komunës
2. z. Afrim Namani –nënkryetar i komunës etj.

Të pranishëm ishin 22 pjesëmarrës. Prej tyre 11 meshkuj dhe 11 femra.

Rend Dite

1. Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2022-2024
2. Takim me OJQ-të, të rinjtë, Këshilli i Veprimit Rinor Lokal(KVRL)

Fjala hyrëse:

Kryetari i komunës zotëri Xhafer Tahiri fillimisht i njoftoj të pranishmit në pika të shkurtra lidhur me investimet e bëra në Vushtrri gjatë këtyre tri viteve të udhëheqjes së tij, si: shtrimin e rrugëve me asfalt, subvencionet e dhëna për fermerët, investimet në objektet edukativo-arsimore, ndërtimi i fushave sportive, rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtatit të lumenjve, rregullimin e shesheve në qytet, prurjen e ujit të pijes në pothuajse tërë territorin e komunës, menaxhimin e mbledhjes së mbeturinave, projekti pothuajse në mbarim për ndërtimin e zonës ekonomike, etj.

Pas përfundimit të fjalës hyrëse, u hap diskutimi:

1. Arbër Hoxha, përfaqësues i KVRL, në fjalën e tij e vë theksin te rritja e bursave për studentët, socializmin e të rinjve lokal me bashkatdhetarët tanë nga mërgimi.
2. Arianit Jashari, përfaqësues i OJQ "Acess" e vë theksin te mundësia e ndërtimit të një amfiteatri të hapur, investime edhe në pjesë tjera jashtë qytetit, konkretisht në resurset natyrore për shfrytëzimin e tyre nga të rinjtë etj.
Ai gjithashtu kërkon të subvencionohen edhe individët e ndryshëm, të cilët nga përfitimi i asaj mbështetjeje, të njëjtit me njohuritë e fituara do t'i kontribuonin qytetit.
3. Besmir Ahmeti, kërkon subvencionimin e shkollave të futbollit.
4. Xhavit Mehmeti, përfaqësues i sektorit të rinisë, e vë theksin tek organizimi i politikave në sektorin e rinisë, kërkon të ketë rigorozitet më të madh në kontrollin e atyre organizatave që përfitojnë në emër të rinisë, gjithashtu kërkon të ketë një strategji lokale për rininë.
5. Shkëlqesa, kërkon që të ndryshohet rregullorja e politikave të komunës në raport me subvencionimin e OJQ-ve lokale, në mënyrë që të subvencionohen OJQ-të më shumë, ngase përkrahja e deritanishme nuk u mjafton për aktivitetet rinore për të cilat merret ai subvencion.

Procesmbajtës:

Premtim Maloku

